



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2725 / prot.

Elbasan, me 14.11.2023

VENDIM

Nr 37 datë 14.11.2023

PËR

**NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 10 , DATË 24.03.2023
"PËR MIRATIMIN E PLANBUXHETIT VJETOR 2023" TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI", TË NDRYSHUAR DHE DETAJIMIN E FONDEVE SHITESË PËR
VITIN 2023**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE " Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr. 75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", Shkresës së MAS nr. 6440/1 prot, datë 26.10.2023 "Për ndryshime në planin e Buxhetit të vitit 2023", Shkresës së MAS nr. 6507/1 prot, datë 26.10.2023 "Për ndryshime në planin e detajuar të Buxhetit të vitit 2023, sipas aneksit nr. 5, datë 18.10.2023" (në UE nr. 2697/1 prot, datë 13.11.2023), Shkresës së MFE nr. 15103/3 prot, datë 30.10.2023 "Dërgohet detajimi i grantit për vitin 2023" (në UE nr. 2697 prot, datë 13.11.2023, Shkresës së MAS nr. 6770/1 prot, datë 30.10.2023 "Mbi detajimin e ndryshimeve sipas Aktit normativ nr. 5, datë 18.10.2023" (në UE nr. 2728 prot, datë 14.11.2023), Vendimit të Senatit Akademik Nr. 04 , datë 17.03.2023 "Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2023", i ndryshuar, Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 10 , datë 24.03.2023 "Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2023" të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e detajimit të "Fondeve (shpenzime korente) të miratuara për vitin 2023" për Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i projektit	Kod	Llogaria Ekonomike	Fondet e miratuara 2023
1	Paga e shpërblime	91105AA	6000000	18,289,790
				18,289,790

2. Detajimin e grantit, sipas tabelave bashkëlidhur.
3. Miratimin e ndryshimeve në Planbuxhetin vjetor të vitit 2023 sipas tabeave bashkëlidhur.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DËRMISHI**

